



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.450/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.450/2025, Anr.453/2025, Anr.454/2025, Anr.455/2025, Anr.458/2025, të datës 07.02.2025.

II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,500.00 (pesëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohen kandidatet e subjektit politik LVV, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojnë nga rrjetet sociale facebook, postime dhe video, dhe atë: Fitore Pacolli, postimin e videos me titull "*Cep me cep edhe në Drenicë*" datë 28 Janar 2025; Dejana Mihali, postimin "*Ende asnjë distancim nga huliganizmi i drejtuar nga Sami Lushtaku...*". 28 Janar 2025, kandidati për deputet aktualisht kryetar i këtij subjekti, video me postimin "*Dita e 20-te e fushatës, takimi me Husamedin Abazi – përfaqësues fetar*", 31 Janar 2025, Albulena Haxhiu postimin "*Sami Lushtaku datë 28 Janar 2025*", Haxhi Avdyli postimin "*Malisheva cep me cep datë 25 Janar 2025*".

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.450/2025, Anr.453/2025, Anr.454/2025, Anr.455/2025, Anr.458/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

-Në ankesën Anr.450/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025, në ora 17:17h, kandidatja për deputete nga radhët e LVV, znj. Fitore Pacolli ka postuar në profilin e saj në facebook video

incizim më përmbajtje të gjuhës urrejtëse ndaj subjektit politik PDK duke deklaruar se ...*Turma e madhe e qytetareve kishin dal në mbështetje të Kryeministrit Kurti, e ca huliganë të angazhuar nga PDK-ja, tentuan t'a ndalojnë. Por ja që qytetarët e Skenderajt kanë vendosur ndryshe e do të vendosin ndryshe pra kësaj radhe ata do votojnë për Qeverinë më të mirë që ka pasur Kosova, pra qeverinë Kurti 3. Ata nuk janë peng i liderëve që kërcënojnë e i shantazhojnë për interesat e tyre politike.* Parashtruesi i ankesës thekson se ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 35,000.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e znj. Fitore Pacolli. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur linkun <https://www.facebook.com/fitorepacollidalipi/videos/2350588898630621> si dhe Screenshoot i postimit të publikuar nga znj.Fitore Pacolli, në të cilën argumentohet koha dhe data e shpërndarjes së Postimit me përmbajtje të gjuhës nxitëse dhe përçarëse;

-Në ankesën Anr.453/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 në ora 19:42/h, mbështetësja e subjektit politik LVV, aktualisht Koordinatore e Komuniteteve në Lëvizjen Vetëvendosje znj. Dejana Mihali, ka publikuar një postim në rrjetin social facebook në të cilin shkruan : “a shkoj sot në Klinë të Epërme të Skenderajt, kandidati i PDK-së Bedri Hamza”,Me Saminë bashkë a vetëm? **Ende asnjë distancim nga huliganizmi drejtuar nga Sami Lushtaku**, as shtabi i PDK-së as kandidati i PDK-së. **Programi “treni elektrik” realiteti banditizmi”**. Parashtruesi i ankesës thekson se ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 35,000.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e znj. Dejana Mihali. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur postimin e publikuar në profilin e znj. Dejana Mihali në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/dejana.mihali/posts/pfbid02uaebzIuvK84g4VxĚ661uXsNdAYMoNpkxb7cie4vaKiHrRbAsrPsfKDvn4vĚLtĚSDI>;

-Në ankesën Anr.454/2025, në të cilën pretendohet se më datë 31 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht kryetar i këtij subjekti politik si dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook, me tekstin shoqërues si në vijim: *Dita e 20-të e fushatës, Prishtinë-Rahovec-Prishtinë. Të inspiruar nga tregimet e mbështetjes së nënave vetushqyese, në takime me qytetarë cep më cep Rahovecit. Kur jemi në atë anë të Kosovës, nuk mund të kalojmë pa u ndaluar në Krushë të Madhe. Prej aty, në dy tubime të njëpasnjëshme, një në Rahovec e një në Prishtinë*”, në të cilën video, në një sekuencë shihet z. Albin Kurti me në një takim me z. Husamedin Abazi - hoxhë - i punësuar në organizatë fetare. Po ashtu në ankesë thekson ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.296/2025, të datës 04.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 3,000.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e z. Albin Kurti. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur linkun <https://www.facebook.com/atch/?v=593223930300100&rdid=MDFrybR8QgBĚ53ZG>.

-Në ankesën Anr.455/2025 theksohet se me datë 28 Janar 2025, në ora 00:19/h, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj.Albulena Haxhiu, ka postuar në profilin e saj në rrjetin social në facebook, deklarim me përmbajtje së gjuhës nxitëse dhe urrejtëse ndaj anëtarëve të PDK-së duke deklaruar **...Sami Lushtaku mbrëmë personalisht ka tentuar ta sulmojë eskortën e Kryeministrit. Ai me veturë zyrtare, 02Z të Komunës së Skenderajt e ka pre rrugën e Kryeministrit më qëllim sulmi. Dëgjova që disa gazetarë të Klan Kosovës, e kanë pyetur kryeministrin se po i përdor veturat zyrtare, ndoshta është më mirë me e pyet Saminë se prej së cilës pompë të benzines i ke komandu Huliganët e tu para se të nisësh si i frustuar.** Parashtruesi i ankesës thekson se ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 35,000.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e znj.Albulena Haxhiu. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur linkun e postimit <https://ëëë.facebook.com/albulenaa.haxhiuu/posts/pfbid02AË93JuooPmYbYqPokGHNaU7395MmGFj96QP7tFt3gp981MptVfBXeb4vh3B3BUYdl>.

-Në ankesën Anr.458/2025, theksohet se me datë 25 janar 2025, në ora 20:47/h, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Haxhi Avdyli, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook, e cila vazhdon të jetë e pranishme në profilin e tij, ku i njëjti kësaj video i ka bashkangjitur tekstin shoqërues, duke përdorë gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt partive kundërshtare, konkretisht, i njëjti në këtë tekst shoqërues shkruan : "Malisheva cep më cep me #qeverinëkurti3, për vazhdimin e punëve të mira për vendin. #skakthimprapa për ata që degraduan çdo gjë, që korrupuan çdo gjë, e që nuk i japin shpresë këtij vendi. #AlbinKurti mbetet opsioni i vetëm për Kryeministër për 4 vitet e ardhshme. Faleminderit Malishevë që guximshëm VVendosët për #VVGUXOALTERNATIVA. #haxhiavdyli 2 1 ". Ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.211/2025, të datës 29.01.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej 5,500.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e z. Haxhi Avdyli. <https://ëëë.facebook.com/haxhi.avdyli.5/videos/533616516398701>.

Në përgjigje në ankesë Anr.450/2025, nga subjekti politik theksohet se sanksioni i dhënë nuk mund të përsëritet për shkak se znj. Fitore Pacolli nuk ka përsëritur deklaratën ashtu siç pretendohet dhe për të njëjtën njëherë është dënuar (res judicata), arsyetimi se shkelja vazhdon të prodhojë efekt nuk mund të jetë bazë për një dënim të përsëritur sepse kjo do të cenonte sigurinë juridike dhe do të zbehte rolin e procedurës e cila ka nxjerre njëherë vendim. Konsiderojmë se PZAP ka vlerësuar drejtë vendimin e saj të parë për kandidaten në fjale dhe të njëjtës nuk i ka jep detyrim që të bëjë evitimin e shkeljes në të ardhmen (ex nunc), çka këtë çështje e bën të gjykuar dhe ankesën të pas afatshme. Ndërsa është e pavërtetë citimi i rasteve analoge nga parashtruesi i ankesës pasi që në pikën 7 dhe 8 të ankesës referohet në një rast që fare nuk ka ndonjë ngjajshmëri me objektin e kësaj ankese, pasi që nuk flitet për përsëritje të dënimit ashtu siç ankuesi pretendon rasti A.nr.347/35 i kandidatit Z. Dimal Basha ku PZAP ka urdhëruar fshirjen e postimit bashkangjitur me dënimin e parë, ndërsa znj. Fitore Pacolli nuk është detyruara nga PZAP të bej një gjë të tillë por vetëm është dënuar njëherë (res judicata).

Konsiderojmë se referimi në këto raste ka për qëllim të ngrit paralele të gabuara mes rasteve sepse nuk është e vërtetë se z. Dimal Basha për të njëjtin objekt është dënuar dy herë, mirëpo ai është detyruar nga PZAP të fshij postimin bashkë me kryegjëje dënimin në vlerë 3.000.00€, çka dallon nga rasti i znj. Fitore Pacolli e cila këtë detyrim nuk e ka.

Në përgjigje në ankesë Anr.453/2025, nga subjekti politik theksohet se PZAP ka vlerësuar drejtë vendimin e saj të parë për anëtarin në fjalë dhe të njëjtës nuk i ka jep detyrim që të bëjë evitimin e shkeljes në të ardhmen (ex nunc), çka këtë çështje e bën të gjykuar dhe ankesën të pas afatshme. Gjithashtu konsiderojmë se sanksioni i dhënë nuk mund të përsëritet për shkak se znj. Dejana Mihali nuk ka përsëritur deklaratën ashtu siç pretendohet dhe për të njëjtën njëherë është dënuar (res judicata). Arsyetimi se shkelja vazhdon të prodhoj efekt nuk mund të jetë bazë për një dënim të përsëritur sepse kjo do të cenonte sigurinë juridike dhe do të zbehte rolin e procedurës e cila ka nxjerre njëherë vendim.

Për ankesën Anr.454/2025, nuk ka përgjigje nga subjekti politik LVV.

Në përgjigjen në ankesën Anr.455/2025, nga subjekti politik theksohet se ankesa e tillë, është e paqëndrueshme dhe e pabazuar, kjo për faktin se e njëjta në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhte deklaratën/veprimin e pretenduar si shkelje dhe e cila, do të binte ndesh me nenin 34 të LZP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11. Fillimisht për rastin e njëjtë, është vendosur në numrin AA Nr 32/2025 të Gjykatës Supreme më të cilën është vendosur që vendimi i PZAP-së lidhur me ankesën Anr.245/25. Ankuesi cek faktin se për të njëjtën çështje është nxjerrur vendim nga PZAP për dënimin e kandidatës Albulena Haxhiu me të njëjtin objekt shqyrtimi së bashku me ankesat tjera të natyrës së njëjtë dhe ngjarjes së njëjtë. Konsiderojmë se PZAP ka vlerësuar drejtë vendimin e saj të parë për kandidatin në fjalë dhe të njëjtës nuk i ka jep detyrim që të bëjë evitimin. Gjithashtu konsiderojmë se sanksioni i dhënë nuk mund të përsëritet për shkak se znj. Albulena Haxhiu, nuk ka përsëritur deklaratën ashtu siç pretendohet dhe për të njëjtën njëherë është dënuar (res judicata).

Në përgjigjen në ankesën Anr.458/2025, nga subjekti politik LVV theksohet se konsiderojmë se PZAP ka vlerësuar drejtë vendimin e saj të parë për anëtarin në fjalë dhe të njëjtin nuk i ka jep detyrim që të bëjë evitimin e shkeljes në të ardhmen (ex nunc), çka këtë çështje e bën të gjykuar dhe ankesën të pas afatshme. Gjithashtu konsiderojmë se sanksioni i dhënë nuk mund të përsëritet për shkak se z. Haxhi Avdyli nuk ka përsëritur deklaratën ashtu siç pretendohet dhe për të njëjtën njëherë është dënuar (res judicata). Arsyetimi se shkelja vazhdon të prodhoj efekt nuk mund të jetë bazë për një dënim të përsëritur sepse kjo do të cenonte sigurinë juridike dhe do të zbehte rolin e procedurës e cila ka nxjerre njëherë vendim.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se :

-Ankesat janë të bazuara.

Paneli me vendimin e tij Anr.244/2025 të datës 01.02.2025 e ka Pranuar të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248/2025, Anr.249/2025, Anr.250/2025, Anr.257/2025, Anr.258/2025, të datës 29.01.2025 dhe Anr.267/2025, Anr. 268/2025, të datës 30.01.2025, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënimin

më gjombë në lartësi prej 35,000.00 (tridhjetepesëmijë) Euro, dhe e ka detyruar të njëjtën që gjombën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Ndaj vendimit të PZAP-it subjekti politik LVV ka parashtruar ankesë, ndërsa Gjykata Supreme me Aktgjykimin AA 32/2025 të datës 05.02.2025 ankesën e subjektit politik LVV e ka pranuar pjesërisht dhe ka Refuzuar të pabazuara ankesat e parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.244/2025, Anr.257/2025, dhe A.nr.258/2025. Kjo gjykatë ka refuzuar pjesërisht të pabazuar ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, në pjesën tjetër të dispozitivit, përkatësisht në pikën I lidhur me ankesat: A.nr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248/2025, A.nr.249/2025, Anr.250/2025, A.nr.267/2025, Anr.268/2025, dhe pikën III, Vërtetohet.

Në ankesën Anr.450/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025, në ora 17:17h, kandidatja për deputete nga radhët e LVV, znj. Fitore Pacolli ka postuar në profilin e saj në facebook video incizim më përmbajtje të gjuhës urrejtëse ndaj subjektit politik PDK duke deklaruar se *...Turma e madhe e qytetareve kishin dal në mbështetje të Kryeministrit Kurti, e ca huliganë të angazhuar nga PDK-ja, tentuan t'a ndalojnë. Por ja që qytetarët e Skenderajt kanë vendosur ndryshe e do të vendosin ndryshe pra kësaj radhe ata do votojnë për Qeverinë më të mirë që ka pasur Kosova, pra qeverinë Kurti 3. Ata nuk janë peng i liderëve që kërcënojnë e i shantazhojnë për interesat e tyre politike.* (Kjo ankesë i referohet rastit A.nr.249/2025, i vërtetuar me vendimin e sipër theksuar të Gjykatës Supreme).

-Në ankesën Anr.453/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 në ora 19:42/h, mbështetësja e subjektit politik LVV, aktualisht Koordinatore e Komuniteteve në Lëvizjen Vetëvendosje znj. Dejana Mihali, ka publikuar një postim në rrjetin social facebook në të cilin shkruan : *“a shkoj sot në Klinë të Epërme të Skenderajt, kandidati i PDK-së Bedri Hamza”, Me Saminë bashkë a vetëm? Ende asnjë distancim nga huliganizmi drejtuar nga Sami Lushtaku, as shtabi i PDK-së as kandidati i PDK-së. Programi “treni elektrik” realiteti banditizmi”.* (Kjo ankesë i referohet rastit A.nr.268/2025, i vërtetuar me vendimin e sipër theksuar të Gjykatës Supreme).

-Në ankesën Anr.454/2025, në të cilën pretendohet se më datë 31 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht kryetar i këtij subjekti politik si dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook, me tekstin shoqëruar si në vijim: *Dita e 20-të e fushatës, Prishtinë-Rahovec-Prishtinë. Të inspiruar nga tregimet e mbështetjes së nënave vetushqyese, në takime me qytetarë cep më cep Rahovecit. Kur jemi në atë anë të Kosovës, nuk mund të kalojmë pa u ndaluar në Krushë të Madhe. Prej aty, në dy tubime të njëpasnjëshme, një në Rahovec e një në Prishtinë”, në të cilën video, në një sekuencë shihet z. Albin Kurti me në një takim me z. Husamedin Abazi - hoxhë - i punësuar në organizatë fetare.* (Kjo ankesë i referohet rastit A.nr.296/2025, datë 04.02.2025, i formës së prerë)

Në ankesën Anr.455/2025 theksohet se me datë 28 Janar 2025, në ora 00:19/h, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj.Albulena Haxhiu, ka postuar në profilin e saj në rrjetin social në facebook, deklarim me përmbajtje se gjuhës nxitëse dhe urrejtëse ndaj anëtarëve të PDK-së duke deklaruar ...Sami

Lushtaku mbrëmë personalisht ka tentuar ta sulmojë eskortën e Kryeministrit. Ai me veturë zyrtare, 02Z të Komunës së Skenderajt e ka pre rrugën e Kryeministrit më qëllim sulmi. Dëgjova që disa gazetarë të Klan Kosovës, e kanë pyetur kryeministrin se po i përdor veturat zyrtare, ndoshta është më mirë me e pyet Saminë se prej së cilës pompë të benzinës i ke komandu Huliganët e tu para se të nisësh si i frustuar. (Kjo ankesë i referohet rastit A.nr.245/2025, i vërtetuar me vendimin e sipër theksuar të Gjykatës Supreme)

Në ankesën Anr.458/2025, theksohet se me datë 25 janar 2025, në ora 20:47/h, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Haxhi Avdyli, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook, e cila vazhdon të jetë e pranishme në profilin e tij, ku i njëjti kësaj video i ka bashkangjitur tekstin shoqërues, duke përdorë gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt partive kundërshtarë, konkretisht, i njëjti në këtë tekst shoqërues shkruan : "Malisheva cep më cep me #qeverinëkurti3, për vazhdimin e punëve të mira për vendin. #skakthimprapa për ata që degraduan çdo gjë, që korrupuan çdo gjë, e që nuk i japin shpresë këtij vendi. #AlbinKurti mbetet opsioni i vetëm për Kryeministër për 4 vitet e ardhshme. Faleminderit Malishevë që guximshëm VVendosët për #VVGUXOALTERNATIVA. #haxhiavdyli 2 1 ". . (Kjo ankesë i referohet rastit A.nr.211/2025, datës 29.01.2025, i formës së prerë)

Paneli pas shikimit të postimeve të ofruara si provë materiale të cilat janë publikuar në rrjetin social të kandidatëve për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe koordinatorës së subjektit politik LVV, hetimit të bëra sipas detyrës zyrtare, është vërtetuar se postimet për të cilat ky subjekt është dënuar me vendime të formës së prerë ende ekzistojnë në rrjetin social të kandidatëve. Ka qenë obligim që pas marrjes së vendimit të Panelit të evitohen shkeljet, ndërsa kjo nuk është bërë e që për pasoj shkelet kanë vazhduar të ndodhin. Me vendimet e panelit është konstatuar se këto postime kanë për qëllim etiketimin e subjekteve tjera politike, dhe promovimit të subjektit politik LVV, e veçanërisht etiketimin, dhe krahasimin negativ të subjektit politik, në atë mënyrë që përmes rrjetit social kanë publikuar postime, përkatësisht shpërndarjen në faqen e tij të rrjetit social postime është bërë krahasimi i subjektit përmbajtja e deklarimeve të tilla të konsiderohen gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt subjektit politik PDK, dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se deklaratimet e tilla në kohë të fushatës zgjedhore, kanë për qëllim të krijojnë. Ndërsa kjo është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se : *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidatet, përkatësisht subjekti politik LVV përkundër vendimit të formës së prerë të PZAP-it A.nr.244/2025 datë 01.02.2025, vendimit A.nr.211/2025 dhe Anr.296/2025, nuk i janë përmbajtur detyrimet që të largojnë postimet nga rrjeti social facebook, andaj bazuar në këtë vendim të PZAPI-it, urdhërohet kandidatet nga subjekti politik LVV, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojnë postimet e publikuara nga rrjeti social facebook. Njëherit njoftohet subjekti politikë në fjalë se duhet të veprojnë sipas nenit 120, par.2 të LZP, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së

përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paraf 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.450/2025 më datë 10.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.46/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija - Ymeri kryetare e kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Ragip Namani, anëtarë, lidhur me ankesën subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.450/2025, të datës 10.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET si e themeltë ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) Anr.450/2025, i datës 10.02.2025, sa i përket pikës I, II dhe III të dispozitivit të vendimit, dhe vendoset ashtu që: Refuzohen të pathemelta ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.450/2025, Anr.453/2025, Anr.454/2025, Anr.455/2025, Anr.458/2025, të datës 07.02.2025.

II. Pjesa tjetër e vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) Anr.450/2025, të datës 10.02.2025, në pikën IV të dispozitivit mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.450/2025, të datës 10.02.2025, është vendosur: I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.450/2025, Anr.453/2025, Anr.454/2025, Anr.455/2025, Anr.458/2025, të datës 07.02.2025. II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në



Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,500 €. III. Detyrohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi. IV. Urdhërohen kandidatet e subjektit politik LVV, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojnë nga rrjetet sociale facebook, postime dhe video, dhe atë: Fitore Pacolli, postimin e videos me titull “Cep me cep edhe në Drenicë” datë 28 Janar 2025, Dejana Mihali, postimin “Ende asnjë distancim nga huliganizmi i drejtuar nga Sami Lushtaku...”, 28 Janar 2025, kandidati për deputet aktualisht kryetar i këtij subjekti, video me postimin “Dita e 20-te e fushatës, takimi me Husamedin Abazi përfaqësues fetar”, 31 Janar 2025, Albulena Haxhiu postimin “Sami Lushtaku datë 28 Janar 2025”, Haxhi Avdyli postimin “Malisheva cep më cep” datë 25 Janar 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që të pranohet pjesërisht ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ndaj vendimit A.nr.450/2025 të nxjerrë nga PZAP, dhe të anulohet pika I, II dhe III e vendimit A.nr.450/2025.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.450/2025, i datës 10.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.450/2025, Anr.453/2025, Anr.454/2025, Anr.455/2025, Anr.458/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), PZAP-i, ka nxjerr vendimin Anr.450/2025, të datës 10.02.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli pas shikimit të postimeve të ofruara si provë materiale të cilat janë publikuar në rrjetin social të kandidatëve për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe kordinatorës së subjektit politik LVV, hetimit



të bëra sipas detyrës zyrtare, është vërtetuar se postimet për të cilat ky subjekt është dënuar me vendime të formës së prerë ende ekzistojnë në rrjetin social të kandidatëve. Ka qenë obligim që pas marrjes së vendimit të Panelit të evitohen shkeljet, ndërsa kjo nuk është bërë e që për pasoj shkelet kanë vazhduar të ndodhin. Me vendimet e panelit është konstatuar se këto postime kanë për qëllim etiketimin e subjekteve tjera politike, dhe promovimit të subjektit politik LVV, e veçanërisht etiketimin, dhe krahasimin negativ të subjektit politik, në atë mënyrë që përmes rrjetit social kanë publikuar postime, përkatësisht shpërndarjen në faqen e tij të rrjetit social postime është bërë krahasimi i subjektit përmbajtja e deklarimeve të tilla të konsiderohen gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt subjektit politik PDK, dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se deklaratimet e tilla në kohë të fushatës zgjedhore, kanë për qëllim të krijojnë. Ndërsa kjo është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidatet, përkatësisht subjekti politik LVV përkundër vendimit të formës së prerë të PZAP-it A.nr.244/2025 datë 01.02.2025, vendimit A.nr.211/2025 dhe Anr.296/2025, nuk i janë përmbajtur detyrimit që të largojnë postimet nga rrjeti social facebook, andaj bazuar në këtë vendim të PZAP-it, urdhërohet kandidatet nga subjekti politik LVV, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojnë postimet e publikuara nga rrjeti social facebook. Njëherit njoftohet subjekti politikë në fjalë se duhet të veproj sipas nenit 120, par.2 të L.ZP, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me aprovimin e ankesës të parashtruar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të PZAP-së për arsye se:

Me provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë ankesa së bashku me dëshmitë e ofruara të paraqitura në PZAP, si dhe ankesa drejtuar kësaj gjykate, shihet qartë se në këtë rast edhe pse postimet e subjektit politik kanë të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: *“1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit*



ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”, në mungesë të urdhrit të lëshuar nga PZAP, për evitimin e shkeljeve, të të njëjtës nuk mund ti shqiptohet gjobë.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë shihet se subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), për shkaqet e njëjta të ngritura me ankesë është gjobitur edhe më parë nga ana e PZAP-së, gjë që nuk është kontestuese as nga parashtruesi i ankesës, e as nga PZAP. Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i PZAP-së, është në kundërshtim me nenin 120 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: “1. Në rast se PZAP, përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të: 1.1. urdhërojë një subjekt politik ose një organizatë vëzhguese të ndërmarrë masa përmirësuese, 2. Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-së brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-së, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-ja”.

Nga dispozita e lartcekur shihet qartë se në rastin konkret nuk mund ti shqiptohet një subjekti politik dënim me gjobë dy herë për të njëjtën çështje, nëse PZAP, me vendimin paraprak nuk ka urdhëruar subjektin politik që ti evitoj shkeljet e konstatuara. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës kjo gjykatë gjeti se PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës me vendimin paraprak, nuk e ka urdhëruar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), që të ndërmarr veprime për evitimin e shkeljeve, prandaj shqiptimi i gjobës në këtë rast është i pa drejtë dhe jo i ligjshëm. PZAP, në arsyetimin e saj ka theksuar se subjekti politik ka qenë i obliguar që ti evitoj shkeljet, por një konstatim të tillë nuk e ka mbështetur në prova dhe fakt konkrete prandaj si i tillë nuk qëndron. Gjykata Supreme vlerëson se vetëm në rastet kur PZAP, ka urdhëruar subjektin politik që ti evitoj shkeljet, ndërsa subjekti politik nuk ka vepruar sipas urdhrit të PZAP-së, e njëjta ka të drejtë ti shqiptoj gjobë shtesë, për mos përfillje të urdhrit të saj ashtu siç përcaktohet me nenin 120 të LZP-së.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 34 paragrafi 1 pika 1.11, dhe nenin 120 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË
AA.nr.46/2025 datë 13.02.2025.

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija - Ymeri



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćení radnik




GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-46/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PRISHTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së llogarit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës, së tji, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kuqdestarit të ndërtësës, tçit, personit që punon p n'atë vend me marrësin.

1. Posto primitac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni poste ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaću. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primitac odnoсно član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (priblieno na vratima stana odnoсно prostonije gdje primitac zaposlen)

Më _____ 201____ në ora _____ cis.

dina

u

Kazhaku i refuzimit të marrjes

Kazlog ardhjaunja prijmea

(Te panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebnje precrtati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIGJYKIM 13.02.2025

Numri i shtojave: _____

broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)

Povrdjujemo prijem gorenavegenog pisma (i slovima)

14.02.2025

(Nëshkrimi i marrësit ose i tij që e ka marrë aktin në vend të tij)

Popis primaoca ili licu koje je pismeno primito u zamenio

14.02

Nëshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Nëshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkronjat pse marrësi ose i tij që e ka marrë aktin në vend të tij. Ako je primitac nepismen ili nije u stanju da se popise, popisuje ga dostavljaoc. Napisano zasto primitac nije stavio svoj popis.